



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS –SUHAREKË
MUNICIPAL ASSEMBLY- SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008”, nenit 15, lidhur me nenin 29, pika 2 te Statutit të Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008 e në mbështetje të nenit 14 paragrafi 5, lidhur me paragrafin 7, dhe 8, pika 1, 2 dhe 3, të Rregullores (QRK) Nr.19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimor dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë ----- miratoi këtë:

Projekt-V E N D I M

Për formimin e komisionit përzgjedhës

Neni 1

- 1.1 Formohet komisioni përzgjedhës për intervistimin me shkrim dhe me gojë te kandidatëve që kanë konkurrar në konkursin për drejtor/esh dhe zëvendësdrejtor/esh të shkollave fillore të mesëm të ultë, (SHFMU) të shpallur nga NjMBNj-ja në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit të Komunës së Suharekës.
- 1.2 Komisioni është ad hoc dhe mandati i ti përfundon me nxjerrjen e vendimit/eve përfundimtare/ për përzgjedhjen e kandidatit/ve në pozitën/at e kërkuar me konkurs dhe ka këtë përbërje:
 - 1.2.1 Sahadet KUQI-----përfaqësues i DKA-së-----kryesues
 - 1.2.2 Arta HOTI-----përfaqësuese e këshillit të prindërve----anëtare
 - 1.2.3 Anëtar i tretë vjen nga MASHTI, sipas Rregullores (QRK), Nr.19/2024.
 - 1.2.4 Anëtar dy përfaqësues të këshillit drejtues nga IEAA-AP, një prind dhe një mësimdhënës në cilësinë e vëzhguesve pa të drejt vote në se cilin institucion ku është duke u zhvilluar procedura e konkursit.

Neni 2

Detyrë e këtij komisionit përzgjedhës është që të bëjë intervistimin e kandidatëve të cilit kanë konkurrar në këtë konkurs dhe në bazë të pikëve të fituar, bën ranglistën e kandidatëve dhe i rekomandon Kryetarit të Komunës për zgjedhjen e drejtorit të shkollës sipas konkurseve.

Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS –SUHAREKË

01-Nr-_____
Më datë_____

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI